



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	01.06.2021
Referenc-ë:	07-353/04-96206/21
Për/ Za/ To:	“NIRAS IC SP.z.o.o”
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr. protokoll 07-353/04-96206/21 nga “NIRAS IC SP.z.o.o” me të cilën kërkohet që me datë 3 Qershor 2021 nga ora 10:00 deri në 18:00 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike dhe vendosja e tendës 5x5 në sheshin “Zahir Pajaziti”.

Në kuadër të projektit “Supply of Project management, air quality information management, behavior change and communication service” do të zhvillohet aktiviteti i Ditëve të Informimit për Cilësinë e Ajrit ku të pranishëm do të jenë zyrtarët nga IKSHP dhe IHMK, si dhe aktiviteti mëso dhe luaj i cili do të organizohet për fëmijë në bashkëpunim me OJQ Science for Change Kosovo.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481,jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 3 Qershor 2021 nga ora 10:00 deri në 18:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.